

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime te tjera

Nr	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
11	Administrata zgjedhore, partitë politike dhe shoqëria civile duhet të përpiqen t'i përmirësojnë më tej programet për edukimin e zgjedhësve, veçanërisht në nivel qarku. Mund t'i kushtohet vëmendje përshtatjes së iniciativave për nevojat e pakicave kombëtare, veçanërisht romëve dheegjiptianëve, dhe zgjedhësve me aftësi të kufizuara.	Progres i Kënaqshëm	Aktualisht KQZ, me mbështetjen financiare të donatorëve të huaj është angazhuar në një proces intensiv informimi dhe edukimi të zgjedhësve. Zyra e prezencës së OSBE në Tiranë ka nxitur angazhimin e donatorëve për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile. Ka nisma nga ambasada të vendeve të ndryshme, ambasada angleze, holandeze, suedeze etj.. për të mbështetur projekte që targetojnë çështje të pjesmarrjes në zgjedhje të pakicave kombëtare, votuesve që ju përkasin grupeve të marginalizura, zgjedhësve me aftësi ndryshe. Është e domosdoshme që të rritet cilësia e punës dhe niveli i organizimit dhe bashkëveprimit midis organizatave të ndryshme, të shtrihen aktivitetet për informimin, edukimin dhe nxitjen e qytetarve në zonat rurale për pjesmarrje në zgjedhje. Është e domosdoshme diversifikimi i mbështetjes nga donatorët për organizatat e shoqërisë civile.